



Menaxhimi i Projekteve

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Menaxhimi i Projekteve

Përmbajtja

Menaxhimi i Projekteve;

I

- ▶ Struktura e organizimit të projektit
- ▶ Kultura organizative dhe rëndësia e saj;
- ▶ Menaxhimi i ekipit të projektit dhe Lidershipi
- ▶ Lideri kundrejt menaxherit
- ▶ Zyra e menaxhimit të projekteve



Menaxhimi i Projekteve;

Struktura e organizimit të projektit

Kultura organizative dhe rëndësia e saj;

Zyra e menaxhimit të projekteve

Menaxhimi i ekipit të projektit dhe Lidershipi

Lideri kundrejt menaxherit

Cfarë është Projekti

Një set unik i aktiviteteve të koordinuara, me afat të definuar të fillimit dhe mbarimit, të ndërmarra nga një individ ose organizatë për të përmbushur objektivat specifike brenda orarit të përcaktuar, koston dhe parametrave të performancës.



Struktura e organizimit & kultura e organizates

Elementet kryesore të mjedisit në të cilën zbatohen projektet brenda një ndërmarrje janë:

- ❑ Struktura e menaxhimit të projekteve dhe
- ❑ Kultura e e organizatës



Struktura e organizimit të projektit

- ▶ Fjala strukturë nënkupton organizim.
- ▶ Struktura e organizimit përbëhet nga disa elemente kryesore:
 - **Projekton lidhjet formale të raportimit**, duke përfshirë nivelet në hierarki dhe hapësirën e kontrollit të menaxherëve dhe supervisorëve.
Kush, ku raporton në hierarkinë organizative
 - Zona e kontrollit, ku caktohet numri i vartësve që raportojnë drejtpërdrejtë tek cdo mbikqyrës




Format e strukturës së organizimit

vazhdim

- ▶ Struktura e organizimit përbëhet nga disa elemente kryesore:
 - **Identifikon grupimin** e individëve në departamente dhe departamenteve në ndërmarrje.

Shkaqet e krijimit të departamenteve, divizioneve, njësive janë :

1. **Funksioni** (grupimi i njerëzve që kryejnë aktivitete të ngjashme)
2. **Produkti** (grupimi i njerëzve që punojnë në linja produkti të ngjashme)
3. **Gjeografia** (grupimi i njerëzve brenda rajoneve të ngjashme gjeografike apo vend-ndodhje fizike brenda dep.)
4. **Projekti** (grupimi i njerëzve që përfshihen në të njëjtin project)




Struktura e organizimit të projektit

vazhdim

- ▶ Struktura e organizimit përbëhet nga disa elemente kryesore:
 - **Përfshinë projektimin e sistemeve për komunikim**, koordinim dhe integrim efektiv brenda departamenteve të ndërmarrjes.


Komunikimi efektiv tek disa ndërmarrje sigurohet përmes rregulloreve, procedurave të brendshme, ku rregullohen edhe llojet e informacioneve që ata duhet të shkëmbejnë.

Tek disa ndërmarrje ku zhvillohen projekte përdoren metoda më të sofistikuara si krijimi i një zyre special të projektit të ndarë nga pjesa tjetër e ndërmarrjes, ku anëtarët e grupit të projektit punojnë gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.



Strukturat e organizimit të projektit

- ▶ Brenda kontekstit të menaxhimit strategjik funksionojnë dy struktura të dallueshme njëkohësisht si:
 - **Struktura e përgjithshme e organizimit** në të cilën zhvillohet projekti, ku pëfshihen të gjitha grupet e interes që marrin pjesë në zhvillimin e projektit (grupi I projektit, menaxhmenti I lartë I org., klientët, partnerët etj.
 - **Struktura e brendshme e grupit të projektit**
që specifikon lidhjet dhe hierarkinë ndërmjet anëtarëve të grupit të projektit, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, ndërveprimin me menaxherin e projektit



Format e struktures se organizimit

Organizimi FunkSIONAL

- Ndërmarrjet strukturohen duke I grupuar njerëzit që kryejn aktivitete të ngjashme.

Organizim projektit me gruper të dedikuara


- Ndërmarrjet strukturohen duke I grupuar njerëzit në grupe projekti në detyra të përkohshme, për kohëzgjatjen e projektit

Organizimi matricë

- Ndërmarrjet strukturohen duke krijuar hierarki dyfishe në të cilën funksionet dhe projektet kanë dominim deri diku të barabartë

Organizimi Funksional

11




Organizimi FunkSIONAL

Përparësitë	Dobësitë
Nuk ka ndryshim të strukturës bazë funksionale të ndërmarrjes	Mungesa e fokusit
Fleksibilitet në përdorimin e stafit	Integrim i dobët ndërfunksional brenda ndërmarrjes
Kalim i thjeshtë Post-projekt	Ngadalësi
	Motivim i ulët pasi mund të shihet si punë shtesë

Organizim projekti me ekip projekti te dedikuar


13



Organizim projektit me grupe të dedikuara

Përparësitë	Dobësitë
I gjithë autoriteti është nën kontrollin e menaxherit të projektit	Kosto e lartë e mbajtjes së grupeve të projektit
Komunikim i përmirësuar ndërmjet grupit të projektit dhe gjithë ndërmarrjen	Mundësia e përdorimit efficient të burimeve është disavantazhe kryesor. Kërkesat për fuqi punetore mund të rritet e ulet shpejt, që e bën pajisjen me staf të vështirë.
Promovim i ekspertizes profesionale të menaxhimit të projektit	E vështirë të ruhet një bërthamë kapitali teknik apo intelektual
Integrim më i madhë ndërfunksional	Shqetësimet e anëtarëve për poziten e tyre të punës pas përfundimit të projektit

Organizim matrice



Organizim matricë

Përparësitë	Dobësitë
Projekti përbën fokusin kryesor	Specialistët kanë të paktën dy epror, atë funksional dhe të projektit, pra hierarki dyfishe
I përshtatshëm në mjedise dinamike	Shpenzim i kohës për negocimin e burimeve kritike dhe ndarjen e tyre në mes projekteve
Nxitë koordinimin ndërmjet njësive funksionale	Shpenzim i kohës për gjetjen e mënyrave të ndarjes së pushtetit me shefat e departamenteve.
Lejon balancim më të mirë të shtrirjes së burimeve kur kemi disa projekte	
Reagimi ndaj nevojave të klientit shumë i shpejtë	

Kultura organizative

- ▶ Nga eksperiencia e organizatave të ndryshme që punojnë me projekte, del se ekzistojnë diferenca të theksuara në mënyrën e menaxhimit të projekteve.
 - ▶ Këto diferenca i atribuohen ndryshimeve në **kulturën organizative** të ndërmarrjeve.
- ▶ Kultura organizative është sjellja e njerëzve brenda një organizate dhe kuptimin që njerëzit ja bashkëngjesin këtyre sjelljeve.
 - ▶ Kultura organizative reflekton “personalitetin” e organizates.



Karakteristikat e Kultures organizative

1. Identiteti I anetareve

- Deri ne cfare mase punetoret identifikohen me ndermarrjen si nje e tere e jo me vendin e punes.

2. Theksi I vecant tek EKIP

- Shkalla ne te cilen organizohen aktivitetet e punes ne grupe e jo me individe

3. Fokusi I Menaxhimit

- Deri ne cfare mase vendimet e menaxhmentit konsiderojne efektin e rezultateve tek njerezit

4. Integrimi I Njersive

- Deri në cfarë mase njësitë funksionale Brenda ndërmarrjes operojnë në mënyrë të koordinuar – METODA PROCES

5. Kontrolli

- Shkalla në të cilën rregullat, politikat dhe mbikqyrja direkte përdoret për të mbikqyrur sjelljen e punëtorëve

Karakteristikat e Kultures organizative

6. Toleranca per Riskun

- Shkalla në të cilën punonjësit inkurajohen të jenë kreativ, inovativ dhe në kërkim të riskut.

7. Kriteret e shpërblimit

- Deri ne cfare mase shpërblime të tilla si rritjet e rrogës dhe bonuset bëhen në përputhje me performancën e punonjësve e jo mbi baza favorizimi

8. Toleranca per konfliktin

- Deri ne cfare mase punetoret inkurajohen qe te kritikojne hapur

9. Mjetet / orientimit final

- Deri në cfarë mase menaxhmenti fokusohet tek rezultatet se sa tek teknikat për arritjen e rezultateve

10. Sisteme te Hapura

- Shkalla me të cilën ndërmarrja monitoron dhe l përgjigjet ndryshimeve të mjedisit të jashtëm


Forcat që ndikojne ne Kulturen Organizative

Faktoret kryesor qe ndikojne ne kulturen organizative:

- ▶ Teknologjia
- ▶ Mjedisi
- ▶ Vendodhja gjeografike
- ▶ Rregullat dhe procedurat
- ▶ Sistemet e pagesave



**Dimensioni
Kulturor I nje
Organizate
perkrahes
ne
Menaxhimin
e Projekteve**



Lidership vs. Menaxhimi

- ▶ Në dekadat e fundit zhvillohet një debat intensiv mbi raportet në mes lidershipit dhe menaxhmentit.
- ▶ Lidershipi në shumë çka është i ngjashëm me menaxhimin.

Por këto dy koncepte nuk janë identike

- ▶ Lidershipi mësohet qysh nga koha e Aristotelit ndërsa shkenca e menaxhmentit është dukuri e dy shekujve të fundit me paraqitjen e shoqërive të industrializuara (revolucioni industrial).
- ▶ Menaxhmenti u paraqit si rezultat i orvatjeve për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të organizatave.



Lidership vs. Menaxhimi

Kotter (1990) krahasoi funksionin e menaxhmentit dhe funksionin e lidershipit.

- ▶ Funksioni bazë i menaxhmentit është të siguroj **konsistencë** dhe rend në organizatë ndërsa funksioni i liderit është të **nxisë ndryshime dhe lëvizje** të organizatës.



Menaxhmenti	Lidershipi
Krijon rregulla dhe konsistencë	Nxit ndryshime dhe lëvizje organizatës
Planifikim dhe buxhetim <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i agjendës • Përcaktimi i orarit të aktiviteteve • Shpërndarja e resurseve 	Drejtim <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i vizionit • Ofrimi i një pasqyre më të gjerë për realitetin • Përcaktimi i strategjisë
Organizimi dhe punësimi <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i strukturës • Hapja e vendeve të punës • Përcaktimi i rregullave dhe procedurave 	Shpërndarja e resurseve <ul style="list-style-type: none"> • Drejtim në realizimin e qëllimeve • Kërkim të devotshmërisë • Ndërtim të ekipeve dhe koalicioneve
Kontrolli dhe zgjedhja e problemeve <ul style="list-style-type: none"> • Inkurajimi i punonjësve • Zgjedhja kreative e problemeve • Ndërmarrja e veprimeve kolektive 	Motivim dhe inspirim <ul style="list-style-type: none"> • Inspirim dhe energji • Dhënia e autorizimeve tek vartësit • Përmbushja e nevojave të vartësve

Lidership vs. Menaxhimi

- ▶ Bennis dhe Nanus vlerësojnë se menaxhmenti nënkupton realizim të aktiviteteve dhe rutinë ndërsa lidershipi nënkupton ndikim tek tjerët dhe krijim të vizionit të ndryshimeve, sipas tyre: *“menaxherët janë ata që e bëjnë punën në mënyrën e duhur ndërsa liderët janë ata të cilët e bëjnë punën e duhur”*.
- ▶ Sipas Rost (1991), lidershipi është ndikim i dyanshëm ndërsa menaxhmenti është raport i njëanshëm i autoritetit. Lidershipi përqendrohet në procesin e realizimit të qëllimeve të përbashkëta ndërsa menaxhmenti në bashkërenditjen e aktiviteteve për realizimin e punëve.



Lidership vs. Menaxhimi

- ▶ Menaxhmenti merret me ruajtjen e rendit dhe stabilitetit ndërsa lidershipi me kërkimin e ndryshimeve konstruktive.
- ▶ Edhe pse aktivitetet e menaxhmentit dhe lidershipit dallohen nuk mund të ketë zhvillim të organizatës, nëse organizata nuk ka menaxhment dhe lidership të mirë.
- ▶ Që të kemi organizata të suksesshme duhet të kemi menaxhment me ekspertizën e duhur dhe lider me aftësitë e duhura.

Lidershipi vs. menaxhimi- konkluzion

- ▶ Edhe pse ekzistojnë dallime në mes **menaxhmentit dhe lidershipit këto dy sfera në segmente të ndryshme përplasen**. Kështu, kur menaxherët ndikojnë në grupin për realizimin e qëllimeve të përcaktuara ato janë të kyçur në procesin e lidershipit, në njëjtën kohë kur lideret inkuadrohen në planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin në fakt kyçen në procesin e menaxhmentit. Të dyja proceset ndikojnë në grupin me qëllim që të realizohen qëllimet.
- ▶ Lidershipi merret me raportet ndër-personale duke instaluar shpirtin e duhur në organizatë/komunitet.

Zyra e menaxhimit te projektit (PMO)

- ▶ Zyra e menaxhimit te projektit (PMO) percaktohet si nje njesi e centralizuar Brenda ndermarrjes ose departamentit qe mbikqyre menaxhimin e projekteve.
- ▶ PMO si qender burimi per menaxhimin e projekteve krijon avantazhe te shumta:
- ▶ E para: menaxheret e projekteve angazhohen ne nje numer te madh punesh.
- ▶ E dyta: ekziston nje boshlluk i madh ne njohuritë qe menaxherët dhe grupet e projektit duhet të kenë.

Zyra e menaxhimit te projektit (PMO)

- ▶ PMO mund të shërbej si një pikëreferim për të gjitha mësimet e nxjerra, për dokumentacionet e projektit dhe regjistrimet përkatëse të projekteve aktuale dhe të kaluara.
- ▶ Tre format alternative të PMO në përshtatjen me qëllimet e ndërmarrjes kanë:
 - ▶ Stacion njekje
 - ▶ Kullë kontrolli si dhe
 - ▶ Qendër burimi



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu